



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483.

Neni 17.3, nën (c) dh (d) Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/15 dhe Ligjit për Ndryshimin dhe LPH, nr. 03/L-106, nenit 29. 58 pika g.h.i. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 30/L-040, nenit 38. pika 1. 2. dhe 5. dhe nenit 108. pika 3. dhe 4. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështirim të pikës IV. dhe V. të Vendimit mbi miratimin e Planit Zhvillimor Komunal: " Gjilani 2015+", nr. 01-11736 të dt. 30.10/2008, si dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, nr. 264, të dt. 18.05.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë: 29.06.2012, nxjerr këtë:

Vendim

Për miratimin e Planit Investiv për Infrastrukturën e Ujësjetës dhe Kanalizimit në teritorin e Komunës së Gjilanit

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Plani Investiv për Infrastrukturën e Ujësjetës dhe Kanalizimit në teritorin e Komunës së Gjilanit, (në tekstin e mëtejshëm: P.I.U.K.) në tërësi sipas paraqitjes tekstuale, grafike dhe parametrave financiar në Dokumentin Investiv të hartuar nga grupi Punues Komunal, në bazë të Vendimit nr. 264/11 të dt. 19.05.2011.

Neni 2

Me P.I.U.K. nga pika 1. e këtij vendimi janë planifikuar dhe zbërthyer fazat orientuese të investimeve dhe realizimit të projekteve konkrete për secilin rast veq e veq.

Neni 3

P.I.U.K. është bazuar në dokumentet themelore-Planin Zhvillimor Komunal: "Gjilani-2015" dhe Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit të vitit 2008, dhe i njëjti është komponent e këtyre Planeve për fushën e infrastrukturës së ujësjetës dhe kanalizimit.

Neni 4

P.I.U.K. është obligativ për kopmanitë regjionale dhe lokale si dhe subjektet tjera të involvuara dhe ndërlidhura me këtë plan me rastin e përgaditjes së dokumentacionit, realizimit të projekteve investive konkrete dhe menagjimit të tyre.

Neni 5

Realizimi i projekteve që involvon dhe ndërhyjnë në teritorin e dy e më tepër komunave, do të bëhet në bazë të memorandumit të mirkuptimit me ato komuna.

Neni 6

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është edhe Plani Investiv për Infrastrukturën e Ujësjetës dhe Kanalizimit në Komunën e Gjilanit, në dy kopje origjinale të shkruara dhe 1. kopje digjitale në gjuhën shqipe dhe angleze.

Neni 7

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes DUMM, DGJKP, DSHP të KK-ës Gjilan, KRUK-Hidromorava dhe Ekipa Mengajuese Komunale.

Neni 8

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.